

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional

SKELETKURRIKULI

Për Drejtimin Mësimor

PËRPUNIM DRURI

Niveli IV i KSHK
(1 vjeçar)

Kodi: C-IV-24

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2024

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.**
 - 1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.
 - 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.
 - 3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.
 - 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtijshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.
- III. Plan i mësimor për drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Programi orientues i praktikës profesionale të integruar, të nivelit**

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK, është zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar si teknik (përgjegjës prodhimi) në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me përpunimin e drurit, si dhe për të vijuar arsimin dhe formimin në nivele më të larta”. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me reptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga profilet e nivelit III të KSHK të drejtimit mësimor “Përpunim druri”;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MEKI përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente.

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërin nga profilet mësimore të nivelit III, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të hartojë një plan-bisnesi që lidhet me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare gjatë veprimtarive profesionale përkatëse.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin që lidhet me veprimtaritë profesionale në fushën e përpunimit të drurit.
- Të zbatojë bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale përkatëse.
- Të zbatojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale përkatëse.
- Të zbatojë standardet teknike (ISO) në fushën e përpunimit të drurit.
- Të analizojë, planifikojë dhe organizojë punimet në repart ose fabrikë të përpunimit të drurit.
- Të mbikëqyrë procesin e sigurimit dhe ruajtjes së lëndës së parë dhe ndihmëse.
- Të mbikëqyrë fluksin e qarkullimit të lëndës së parë në çdo proces.
- Të mbikëqyrë funksionimin e sistemeve të transportit të brendshëm.
- Të zërbërthejë dhe përpunojë fletët e vizatimit të planimetrisë së repartit të punës.
- Të zërbërthejë dhe përpunojë fletët e vizatimit të objekteve prej druri.
- Të zërbërthejë dhe përpunojë fletët e vizatimit për arëdimin e nevojshëm të ambienteve të ndryshme dhe bashkohore.
- Të zërbërthejë skemat e punës të pajisjeve, makinave, linjave konvejer në fabrikat e përpunimit të drurit.
- Të ndjekë zbatimin e punimeve për realizimin e pllakave me bazë druri si pllakë zdrukthi, fibre, panel, kompensatë dru i shtresuar etj.
- Të ndjekë zbatimin e punimeve për prodhimin e objekteve të ndryshme prej druri si mobilje, mobilje të tapicuara, objekte speciale prej druri, artizanale, objekte druri për fushën e ndërtimit si kapriata, kallëpe, trarë, dyer, dritare etj.
- Të ndjekë zbatimin e punimeve sipas grafikut të punimeve në repartin e punës
- Të përgatitë makinën nga ana teknike dhe e sigurisë.
- Të punojë në makina të kompjuterizuara të përpunimit të drurit pllakat me bazë druri si pllakë zdrukthi, fibre, panel, kompensatë dru i shtresuar etj, si dhe përgatitje të detaleve të ndryshme sipas modelit të kërkuar.
- Të kryejë punime speciale në poste pune të repartit, si përcaktime të vetive të drurit dhe prodhimeve gjysmë të gatshme.
- Të ndjekë zbatimin e rregjimeve në procese të ndryshme të prodhimit, gjatë trajtimit hidro-

- termik, termik të drurit, presimit, tharjes, defibrimit etj.
- Të ndjekë realizimin e recetave të përgatitjes së kimikateve që përdoren, si lëndët ngjyuese, hidrofuge, ilustruese, ngjyruese, imprenjuese etj.
- Të bashkëpunojë për zbatimin e punimeve të instalimeve të makinave, linjave dhe të transportit të brendshëm etj.
- Të sigurojë funksionimin e pajisjeve të kontrollit
- Të kryejë kontrollin e cilësisë së punimeve
- Të kontrollojë markëtimin dhe ambalazhimin.
- Të hartojë dhe të plotësojë dokumentacionin teknik në repart.
- Të përdorë teknologjinë e programit kompjuterik *EXCEL* dhe *AutoCAD*.
- Të kryejë ngritjen e nivelit të tij profesional dhe përmirësimin e procesit të prodhimit
- Të bashkëpunojë për evidentimin dhe kualifikimin e punëtorëve në repart ose fabrikë.
- Të mbikëqyrë mirëmbajtjen e instrumenteve, veglave, pajisjeve dhe materialeve të punës në mjediset përkatëse.
- Të kryejë saktë veprimet kryesore për të dhënë ndihmën e shpejtë.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.
- Të komunikojë me etikën e duhur në kuadrin e veprimtarive profesionale.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Certifikatën e teknikut të përpunimit të drurit.

Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim si teknik i përpunimit të drurit në institucione të ndryshme, në biznese të përpunimit dhe shërbimit të drurit, në nivelin e teknikut për ndjekjen e proceseve të punës, në pikat e tregëtimit të objekteve prej druri dhe prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e përpunimit të drurit.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.

III. Plani mësimor për drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.

Plani mësimor për drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	15/16 (480/512)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		Fizikë	1
7		Biologji	2
8		Shkenca sociale	1

9		Histori	1
10		Gjeografi	1
11		TIK	1
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	9 (288)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	1
3	L-09-265-24	Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin e drurit	1
4	L-26-266-24	Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elemente projekti	2
5	L-09-267-24	Teknika e tharjes së drurit dhe transporti i brëndshëm	2
6	L-09-674-24	Analiza dhe zbërthimi i projekteve të objekteve prej druri	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	6 (192)
1	M-09-2042-24	Planifikimi dhe organizimi i punës për zbatimin e projekteve në përpunimin e drurit	33
2	M-09-1543-24	Ndjekja e prodhimit të objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.	66
3	M-09-1544-24	Ndjekja e procesit të tharjes së lëndës drunore	33
4	M-26-2043-24	Punime me programe kompjuterike Autocad dhe Excel	60
		Gjithsej A+B+C	30/31 (960/ 992)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 3 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përkrahuesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 ose 6 orëshe

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të

gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit mësimor “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Rekomandohet përdorimi i metodës së “*lojës me role*”, ku nxënësve tu jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Përpunim druri”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet përfundimtare.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar, sipas Udhëzimeve të MASR dhe MEKI.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, me Certifikatën profesionale të nivelit IV të KSHK, si dhe me Suplementin përkatës, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.;
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës 13;
 - rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 13 – 64 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve.
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet.
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë

Tema 1	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
Tema 2	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
Tema 3	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
Tema 4	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
Tema 5	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
Tema 6	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë
Tema 7	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
Tema 8	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
Tema 9	Buxhetimi në biznes	4 orë
Tema 10	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë
Tema 11	E – sipërmarrja	2 orë
Tema 12	Veprimet individuale me bankat	3 orë
Tema 13	Siguracionet personale	3 orë

2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12), kl.13 – 32 orë

• Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.

- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”.
- Të tregojnë sesi ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor.
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 2	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
Tema 3	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis.	3 orë
Tema 4	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	3 orë
Tema 5	Shogëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
Tema 6	Monitorimi i burimeve mjedisore	3 orë
Tema 7	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	2 orë
Tema 8	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
Tema 9	<u>Veprimtari praktike</u> për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal.	3 orë
Tema 10	<u>Veprimtari praktike</u> për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

3. Lënda “Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin e drurit” (L-09-265-24).

Kl. 13 – 32 orë

• **Synimet e lëndës “Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin e drurit”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin e drurit”, kl.13 nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë ligjshmërinë në vendosjen e repart / fabrikës të përpunimit të drurit ndaj zonës të banuar.
- Të përshkruajnë ligjshmërinë në mbrojtje të shëndetit të punëtorëve në fushën e përpunimit të drurit.
- Të përshkruajnë strukturën e një biznesi sipas llojit të objektit prej druri që prodhon.
- Të përshkruajnë ligjshmërinë për marrëdhëniet sipërmarrës - investitor – klient në fushën e përpunimit të drurit.
- Të përshkruajnë veprimtaritë kryesore të organizimit të punës në Përpunim druri.
- Të përshkruajnë veprimtaritë për strukturën organizative në rastin e vetmenaxhimit.
- Të përcaktojnë radhën e punimeve sipas emërimit të punimeve

- Të përshkruajnë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit tatimor, kodin e punës lidhur me aktivitetin që kryen.
- Të rendisin detyrat dhe rolet për çdo punonjës sipas kualifikimit të tyre.
- Të shpjegojnë rëndësinë e plotësimit të planeve ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat.
- Të shpjegojnë rëndësinë e arkivimit të dokumentacionit teknik në përpunimin e drurit.
- Të përshkruajnë mënyrën e regjistrimit të faturave.
- Të përshkruajnë ligjshmërinë në ndërtimin e konstruksioneve prej druri për marrëdhëniet sipërmarrës-investitor- klient sipas përkatësisë.
- Të përshkruajnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në zbatimin e punimeve të drurit.
- Të përshkruajnë planin e organizimit të punimeve në repartet e punës sipas projektit
- Të shpjegojnë rëndësinë e kontrollit të materialeve të punës sipas standardeve.
- Të shpjegojnë mënyrën e hartimit të planit kalendarik të punimeve dhe grafikun e fuqisë punëtore për periudha të ndryshme të ndërtimit në përputhje me planorganizimin e përgjithshëm.
- Të përshkruajnë dokumentacionin teknik të punimeve sipas fazave të prodhimit të objekteve prej druri (kohëshënuesi, bordero, tabela e magazinës së repartit, e zbërthimit të kostos, procesverbale, etj.
- Të plotësojnë për lloje punimesh dhe situata të posacme procesverbalet dhe formularët përkatës.
- Të përshkruajnë rëndësinë e sigurimit të cilësisë.
- Të përshkruajnë mënyrën e plotësimit të dokumentacionit teknik në përfundim të punimeve në makineri, montim etj, të objektit prej druri ose prodhime gjysmë të gatshme.
- Të shpjegojnë rëndësinë e llogaritjes së normave të konsumit të materialeve sipas skedës teknike si dhe të punimeve shtesë.
- Të shpjegojnë rëndësinë e llogaritjes së kostos së personelit punonjës e mbështetës sipas normativave.
- Të shpjegojnë rëndësinë e llogaritjes së kostos së shfrytëzimit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës sipas normativave.
- Të shpjegojnë mënyrën e llogaritjes së çmimit përfundimtar për punimet/shërbimet e ofruara.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin e drurit”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Njohuri për legjislacionin urbanistik për vendndodhjen e repartit / fabrikës të përpunimit të drurit.	4 orë
Tema 2	Njohuri për rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në fushën e përpunimit të drurit	3 orë
Tema 3	Njohuri për planifikimin dhe organizimin e punës	4 orë
Tema 4	Njohuri për sipërmarrjen dhe menaxhimin e biznesit të përpunimit të drurit.	4 orë
Tema 5	Njohuri për dokumentacionin teknik të punimeve në përpunimin e drurit	5 orë
Tema 6	Njohuri për sigurimin e cilësisë së punimeve të produkteve në	4 orë

	përpunimin e drurit	
Tema 7	Njohuri për llogaritjen e kostos dhe çmimeve të produkteve në përpunimin e drurit	4 orë
Tema 8	Njohuri për dokumentimin teknik të punimeve të përfunduara të përpunimit të drurit	4 orë

4. Lënda “Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elementë projekti” L-26-266-24). Kl. 13 – 64 orë

- **Synimet e lëndës “Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elemente projekti”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elemente projekti”, kl. 13. nxënësit duhet:

- Të interpretojnë projektin gjatë ndërtimit të objekteve në përpunimin e drurit.
- Të përshkruajnë hapat e teknologjisë gjatë përgatitjes së pllakave me bazë druri, zdrukthi, fibre, dru i shtresuar, kompensatë, panel.
- Të përcaktojnë hapat e teknologjisë së prodhimit, në repart, fabrikë dhe anekse të tjera, sipas llojit të objektit prej druri apo gjysmë të gatshme si dhe të kapacitetit prodhues.
- Të dallojnë elementet e ndryshëm prej druri që shërbejnë në ndërtim, si trarë prej druri me elementë të rrumbullakët, kallëpe, elementë për kapriata etj.
- Të rendisin hapat teknologjikë për ndërtimin e elementeve të ndryshëm prej druri që shërbejnë në ndërtim, si trarë prej druri me elementë të rrumbullakët, kallëpe, kapriata etj.
- Të përshkruajnë mënyrat bashkëkohore të arredimit të banesave, institucioneve dhe ambienteve të tjera.
- Të përshkruajnë elementet konstruktive prej druri të ndërtesave të thjeshta prej druri (ndërkate, shkallë, shtylla, trarë dhe mure).
- Të rendisin llojet e vozave sipas karakteristikave teknike, lëndës së parë, etj, duke përshkruar veçoritë e tyre.
- Të rendisin hapat teknologjike të prodhimit të vozave duke shpjeguar secilin proces në veçanti, si (zgjedhja e lëndës së parë, skicat, llogaritjet për kallëpe punimi e frezimi etj.)
- Të rendisin tipet e parketit sipas karakteristikave, duke përshkruar përdorimet e tyre.
- Të përshkruajnë hapat teknologjike të prodhimit të parketit duke përshkruar secilin proces.
- Të interpretojnë mënyrën e sigurimit të lëndës së parë dhe materialeve të tjera sipas kushteve teknike.
- Të rendisin makinat e avancuara për përpunimin e drurit.
- Të shpjegojnë ndërtimin, gradimin, mënyrën e programimit të frezave kopjuese (CNC), makinave të montimit të pjesëve metalike, makinave skuadruese të pllakave dhe makinave borduese.
- Të shpjegojnë mënyrat e kontrollit të parametrave të lëndës së parë;
- Të shpjegojnë specifikat dhe karakteristikat teknike të produktit ose objektit që do të prodhohet;
- Të rendisin kriteret cilësore të çdo faze prodhimi;
- Të rendisin defektet që mund të lindin gjatë operacioneve përpunuese në makineri apo pajisje;
- Të shpjegojnë azhustazhet dhe tolerancat përmasore;

- Të rendisin metodat e testimit të vetive fizike, mekanike, kimike dhe teknologjike të materialeve prej druri;
- Të përshkruajnë metodat e testimit të shtresave të lustrës, të bojës dhe shkallës së imprenjimit;
- Të shpjegojnë metodat testuese të performancës së materialeve ndihmëse si aksesorë, tapiceri etj. aksesorëve metalikë, plastikë;
- Të shpjegojnë metodat e testimit të cilësisë së riparimit;
- Të përshkruajnë proceset përfundimtare të prodhimit të objektit prej druri, si marketimin, ambalazhimin dhe depozitim të tij.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elementë projekti”, kl. 13. - 64 orë**

Tema 1	Teknologjia e prodhimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme.	4 orë
Tema 2	Makineritë, pajisjet dhe materialet për prodhimin e objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme	9 orë
Tema 3	Teknologjia e përpunimit të pllakave me bazë druri	5 orë
Tema 4	Restaurimi i objekteve prej druri	5 orë
Tema 5	Prodhime speciale prej druri dhe vozat	4 orë
Tema 6	Teknologjia e prodhimit të vozave	4 orë
Tema 7	Teknologjia e prodhimit të parketit	4 orë
Tema 8	Arredimi i ambienteve	5 orë
Tema 9	Konstruksione ndërtimi të avancuara prej druri	5 orë
Tema 10	Makina të avancuara të përpunimit të drurit.	7 orë
Tema 12	Kontrolli i cilësisë së punimeve	7 orë
Tema 13	Magazinimi i objekteve prej druri	5 orë

5. Lënda “Teknika e tharjes së drurit dhe transporti i brendshëm” (L-09-267-24). Kl. 13 – 64 orë

• **Synimet e lëndës “Teknika e tharjes së drurit dhe transporti i brendshëm”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknika e tharjes së drurit dhe transporti i brendshëm, kl.13, nxënësit duhet:

- Të rendisin vetitë e avullit të ujit dhe ajrit të atmosferës si mjet tharës
- Të shpjegojnë vetitë elastiko-plastike dhe shformimet që shfaqen gjatë tharjes të lëndës drunore (ekulibrin higroskopik) .
- Të shpjegojnë mënyrat e përcaktimit të lagështisë së drurit.
- Të shpjegojnë dallimin ndërmjet tharjes në ajër të lirë dhe artificiale.
- Të shpjegojnë rëndësinë e klasifikimit të dhomave, pajisjeve, makinave etj, që përdoren për tharjen e drurit, ashklave, fibrave etj.
- Të shpjegojnë dallimin e dhomave të tharjes nga pajisjet dhe makinat tharëse.
- Të përshkruajnë funksionimin e pajisjeve që përdoren në dhomat e tharjes për rregullimin e parametrave të ajrit dhe kontrollin e tyre.
- Të shpjegojnë funksionimin dhe përdorimin e kaldajave, sipas llojeve.
- Të shpjegojnë kriteret e zgjedhjes së rregjimit të tharjes së lëndës drunore në tharëse dhe

puna me të.

- Të përshkruajnë metoda të tjera tharjeje dhe të specifikojnë vecoritë e tyre.
- Të tregojnë kërkesat bashkëkohore në teknikën e tharjes.
- Të shpjegojnë mënyrën e përcaktimit të kohës së tharjes sipas faktorëve që ndikojnë.
- Të shpjegojnë mënyrën e llogaritjes së prodhimtarisë vjetore në tharëse.
- Të shpjegojnë mënyrën e përcaktimit të sasisë të avullit të nevojshëm për tharje.
- Të përcaktojnë kriteret të zgjedhjes së mënyrës dhe metodës së tharjes.
- Të klasifikojnë mjetet e transportit të brëndshëm.
- Të lexojnë skemat dhe mënyrën e përdorimit të makinave peshëngritëse, makarave dhe polispasteve.
- Të dallojnë skemën e punës së vinçave-urë nga ata të vinçave-pirun.
- Të lexojnë skemën e punës dhe të shpjegojnë funksionimin e transportierëve me zinxhirë, me rrip, me pllaka dhe me rula.
- Të klasifikojnë transportin me shina.
- Të shpjegojnë funksionin e mjeteve lëvizëse mbi shina treni (platforma, vagona dhe truke).
- Të dallojnë llojet e transportit pneumatik.
- Të shpjegojnë mënyrën e llogaritjes së sistemit grumbullues.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknika e tharjes së drurit dhe transporti i brendshëm”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Vetitë e avujve të ujit dhe ajrit si mjet tharës	3 orë
Tema 2	Ekulibri higroskopik i drurit, përcaktimi i lagështisë së tij.	4 orë
Tema 3	Tharja e drurit në ajër të lirë dhe artificiale	5 orë
Tema 4	Defektet e tharjes	4 orë
Tema 5	Qëllimi dhe mënyrat e tharjes artificiale	4 orë
Tema 6	Tipet e tharëve të drurit, pajisjet	4 orë
Tema 7	Rregjimi në tharëse, instrumentat e kontrollit të tij	4 orë
Tema 8	Treguesit tekniko-ekonomikë të tharjes	4 orë
Tema 9	Transporti i brendshëm	3 orë
Tema 10	Makinat peshëngritëse	7 orë
Tema 11	Makina dhe instalime transporti me organe tërheqëse	7 orë
Tema 12	Makina dhe instalime transporti pa organe tërheqëse	7 orë
Tema 13	Transporti pneumatik	8 orë

6. Lënda “Analiza dhe zbërthimi i projekteve të objekteve prej drurit” (L-09-674-24). Kl. 13 – 32 orë

- **Synimet e lëndës “Analiza dhe zbërthimi i projekteve të objekteve prej druri”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Analiza dhe zbërthimi i projekteve të objekteve prej druri”, nxënësit duhet:

- Të interpretojnë fletët e projektit të planimetrisë të reparteve, fabrikave të përpunimit të drurit.
- Të analizojnë vizatimet e objekteve prej druri.

- Të shpjegojnë përpunimin e vizatimeve të objekteve prej druri.
- Të shpjegojnë mënyrën e zbërthimit, detajimit të objektit sipas radhës, vendosjen e përmasave dhe mbipërmasave.
- Të shpjegojnë mënyrën e hartimit të kartës shoqëruese të detaleve.
- Të shpjegojnë mënyrën e llogaritjes së lëndës drusore.
- Të shpjegojnë mënyrën e llogaritjes së materialeve të tjera ndihmëse, sipas normativave përkatëse.
- Të shpjegojnë mënyrën e përcaktimit të kostos së objektit prej druri.
- Të zgjedhin objektin prej druri sipas kërkesës dhe vendit të përdorimit.
- Të analizojnë objektin prej druri sipas ndërtimit, materialeve etj.
- Të zbërthejnë vizatimin e pamjes së përgjithshme të objektit prej druri sipas vendit ku do përdoret.
- Të vizatojnë dhe të përpunojnë projeksionet ortogonale të objektit prej druri sipas modelit.
- Të vendosë me saktësi sipas modelit përmasat në projeksionet ortogonale të objektit prej druri.
- Të zbërthejnë në vizatim objektin prej druri në pjesë të veçanta ansamble dhe nënasnsamble.
- Të skicojnë objektin në detalet përbërës sipas radhës.
- Të vizatojnë nyjet e lidhjeve dhe bashkimeve sipas kërkesës.
- Të vendosin sipas normave përmasat dhe mbipërmasat në çdo pjesë, nyje dhe detal.
- Të vizatojnë kallëpet dhe shabllonet për punime në makineri
- Të hartojnë kartën shoqëruese, sipas normave, për cdo detal të objektit prej druri, pllake sipas modeleve dhe shablloneve.
- Të hartojnë tabelën përmbledhëse të prerjes sipas radhës së proceseve të punës
- Të përcaktojnë lëndën e drurit dhe materiale me bazë druri si kompensatë, rimeso, pllakë zdrukthi, fibre etj sipas tabelës të prerjes.
- Të hartojnë tabelën me lëndë ndihmëse duke përcaktuar sasinë sipas normativave.
- Të plotësojnë në pasqyrën e planit kalendarik të punimeve llojet e punimeve me sasi të përkatëse sipas preventivit.
- Të zbërthejnë çdo lloj punimi në orë pune specialist dhe punëtor duke përdorur manualët e preventivimit të punimeve të përpunimit të drurit dhe të kthejnë orët e njehsuara në ditë pune.
- Të plotësojnë në pasqyrën e planit kalendarik afatet kohore për çdo punim duke ndjekur radhën e tyre.
- Të hartojnë grafikun e fuqisë punëtore sipas të dhënave të pasqyrës së planit kalendarik të punimeve.
- Të përcaktojnë mënyrën e ambalazhimit të objektit prej druri sipas normave dhe kërkesës.
- Të përpilojnë çertifikatën e cilësisë të objektit prej druri sipas normave të caktuara
- Të përcaktojnë kushtet e depozitimit dhe të ruajtjes të objektit prej druri apo gjysëm të gatshëm prej druri.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Analiza dhe zbërthimi i projekteve të objekteve prej druri”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Analiza e vizatimeve të planimetrisë të reparteve, fabrikave të përpunimit të drurit	3 orë
Tema 2	Analiza e vizatimeve të objekteve prej druri	3 orë

Tema 3	Përpunimi i vizatimeve të objekteve prej druri	3 orë
Tema 4	Zbërthimi i vizatimeve sipas rradhës	4 orë
Tema 5	Llogaritja e lëndës drusore	3 orë
Tema 6	Llogaritja e materialeve ndihmëse	3 orë
Tema 7	Përcaktimi i kostos së prodhimit të objekteve prej druri	3 orë
Tema 8	<u>Detyrë kursi</u> për analizimin dhe zbërthimin e projektit të objektit me bazë druri	10 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Planifikimi dhe organizimi i punës për zbatimin e projekteve në përpunimin e drurit”

Drejtimi: Përpunim druri
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PERSHKUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I PUNËS PËR ZBATIMIN E PROJEKTEVE NË PËRPUNIMIN E DRURIT	M-09-2042-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të analizuar, planifikuar dhe organizuar punën për zbatimin e projekteve në përpunimin e drurit në përpunimin e drurit	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, të kualifikimit në drejtimin mësimor “Përpunim druri”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi bashkëpunon për ngritjen e një reparti të përpunimit të drurit. Kriteret e realizimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të ndjekë zgjedhjen e vendit, sipas normave, në përshtatje me thellësinë e ujrave nëntoksore, furnizimin me ujë dhe energji elektrike, dritën me rrugët dhe brënda repartit; – të ndjekë analizën dhe përpunimin e skicës, vizatimit të planimetrisë së repartit, fabrikës; – të ndjekë zgjedhjen e furnizimit, me lëndë të parë dhe ndihmëse sipas distancës, leverdisë ekonomike etj; – të ndjekë kontrollin e përgatitjes së depozitës si shtresat mbi sipërfaqen, dizifektimin me kimikate, vendosja e bazamenteve prej betoni sipas standarteve; – të bashkëpunojë në përgatitjen e basenave të ruajtjes, apo avullimit dhe të tubave për spërkatje artificiale etj.; – të bashkëpunojë për vendosjen e ndonjë makine të nevojshme për shkurtim; – të ndjekë kontrollin e sipërfaqes së repartit të makinerisë, montimit, magazinës për shtrimin dhe nivelimin; – të bashkëpunojë sipas normave për instalimet e nevojshme elektrike, ngrohjes së repartit si kaloriferë etj.;	

-
- të bashkëpunojë për vendosjen e makinave të përpunimit të drurit dhe ndihmëse sipas teknologjisë;
 - të ndjekë bashkëpunimin për vendosjen e bangove të punës sipas rradhës së proceseve, rafte, pajisje kundra zjaarrit, ndihmës së shpejtë etj.;
 - të bashkëpunojë për instalimin e pajisjeve në sektorin e lyerjes dhe llustrimit;
 - të ndjekë bashkëpunimin për përgatitjen e magazinës së produktit të gatshëm dhe pajisjen e saj me aparate për matjen e parametrave të ajrit;
 - të ndjekë kujdesin për pajisjet dhe instrumentet në të gjitha sektorët e repartit;
 - të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes të repartit të makinerise.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi planifikon punimet

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të njihen me legjislacionin në fuqi (Udhëzimet, VKM etj.);
- të interpretojnë kushtet teknike të zbatimit në përpunimin e drurit;
- të konsultohen paraprakisht me teknikë të specialiteteve të tjera;
- të zbërthejë në mënyrë të saktë dhe të plotë objektet komplekse prej druri në detale të veçanta;
- të realizojë në kohë optimale skica të qarta manuale dhe digjitale vizatimi teknik të detaleve ose të produkteve që do të prodhohen;
- të planifikojë dhe sigurojë burimet njerëzore sipas aftësive;
- të planifikojë mjetet, makineritë, pajisjet dhe instrumentet sipas projektit dhe proceseve të punës;
- të planifikojë llojet e transportit të brendshëm, funksionimin dhe përdorimin e tyre;
- të planifikojë materialet e nevojshme sipas objektit të prodhimit;
- të planifikojë kohën e punës sipas procesit teknologjik të prodhimit;
- të planifikojnë burimet financiare të mundshme;
- të planifikojë proceset e punës sipas rradhës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi organizon punën.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë një organizim optimal të repartit të punës, fabrikës, nga pikëpamja ergonomike;
- të sigurojë burimet e nevojshme njerëzore;
- të sigurojë, makineritë, pajisjet dhe instrumentet prerës;
- të sigurojë materialet e nevojshme për prodhim;
- të sigurojë kapacitetet transportuese të sistemeve të transportit të brendshëm dhe atyre të aspirimit;
- të mbykqyrë funksionalitetin e makinerive, mjeteve dhe paisjeve të punës përpara përdorimit të tyre;
- të përcaktojë radhën e punës, që nga sheshi i depozitës së lëndës së parë deri te magazinimi i objektit;
- të ndajë detyrat në ekip;
- të sigurojnë burimet e nevojshme të energjisë dhe ujit;
- të kontrollojë në mënyrë periodike sistemimin, pastrimin e vendit të punës, para gjatë dhe mbas punës;
- të bashkëpunojë me specialistë dhe teknikë të tjerë sipas procesit të punës;
- të sigurojë për eprorët informacion të saktë të plotë dhe në kohë reale, për situatën në repartin e prodhimit;
- të ndjekë vendosjen e tabelave të sigurisë në punë dhe ruajtjen e mjedisit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë organizimit të punës në repart, fabrikë të përpunimit të drurit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi mbikqyr procesin e sigurimit dhe ruajtjes së lëndës së parë

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë në dorëzim lëndën e parë sipas standardit përkatës;
- të ndjekë matjen e parametrave, përmasave të lëndës së parë dhe ndihmëse me instrumentet dhe pajisjet analoge, digjitale përkatëse;
- të ndjekë klasifikimin e lëndës së parë drusore sipas cilësisë dhe përmasave;
- të ndjekë kontrollin e cilësisë së materialeve ndihmëse;
- të depozitojë apo magazinojë në mënyrë optimale lëndën e parë drusore dhe materialet ndihmëse sipas standardit përkatës;
- të marrë masa për ruajtjen e parametrave teknologjikë të lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse;
- të ndjekë kujdesin për pajisjet e punës gjatë procesit të sigurimit dhe ruajtjes së lëndës së parë;

- të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të sigurimit dhe ruajtjes së lëndës së parë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në vënde ku do të ngrihen punishte apo fabrika të përpunimit të drurit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e proceseve të punës për të ndjekur ngritjen e punishtes apo fabrikës së përpunimit të drurit, planifikimit organizimit të punës në të si dhe mbykqyr jes së procesit të sigurimit dhe ruajtjes së lëndës së parë, të organizojë edhe vizita në vënde ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës, për të ndjekur ngritjen e punishtes apo fabrikës së përpunimit të drurit, planifikimit organizimit të punës në të si dhe mbykqyr jes së procesit të sigurimit dhe ruajtjes së lëndës së parë, Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, për ndjekjen e punimeve fillimisht në mënyrë të mbikqyrur pastaj në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës, për të ndjekur ngritjen e punishtes apo fabrikës së përpunimit të drurit, planifikimit organizimit të punës në të si dhe mbykqyr jes së procesit të sigurimit dhe ruajtjes së lëndës së parë,
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve për të ndjekur ngritjen e punishtes apo fabrikës së përpunimit të drurit, planifikimit organizimit të punës në të si dhe mbykqyr jes së procesit të sigurimit dhe ruajtjes së lëndës së parë,
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e mëposhtme:

- Depozitë, repart, fabrikë.
 - Paisje, makina, etj.
 - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
 - Materiali drunor, dërrasë, detale druri, rimeso, ashkla druri, fibra druri etj.
 - Skica të planimetrisë të repartit, fabrikës, skema të vendosjes së basenave, paisjeve, makinave, transportierë etj.
 - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,
 - Kompleti i veshjeve të punës.
-

2. Moduli “Ndjekja e prodhimit të objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme”

Drejtimi: Përpunim druri
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PERSHKUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	NDJEKJA E PRODHIMIT TË OBJEKTEVE PREJ DRURI OSE GJYSMË TË GATSHME	M-09-1543-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të ndjekur dhe kryer punime për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme prej druri.	
Kohëzgjatja e modulit	66 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, të kualifikimit në drejtimin mësimor “Përpunim druri”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi mbikqyr procesin e prodhimit të objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme. Kriteret e vlerësimit Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të analizojë skicën e objektit prej druri ose pllakave të zdrukthit, fibrës, panelit etj; – të bashkëpunojë në zbërthimin dhe përpunimin e skicës me përmasa fikse duke u bazuar te modeli i kërkuar; – të realizojë një qarkullim optimal të lëndës së parë, gjatë procesit të prodhimit; – të mbikëqyrë përgatitjen e makinerive dhe instrumenteve për punë sipas manualeve përkatëse; – të mbikëqyrë funksionimin optimal të sistemeve të transportit të brendshëm sipas manualeve përkatëse; – të mbikëqyrë përgatitjen e lëndëve ndihmëse për punë sipas manualeve përkatëse; – të sigurojë funksionimin e vazhdueshëm dhe optimal të pajisjeve dhe instrumenteve të kontrollit sipas manualeve përkatëse; – të mbikëqyrë me efektivitet performancën e punës së makinerive për prodhimin e produkteve prej druri sipas kriterëve teknike të specifikuar; – të mbikëqyrë me efektivitet performancën e punëtorëve gjatë procesit të prodhimit; – të asistojë në kohë reale në procese pune për prodhimin e produkteve prej druri sipas nevojës;	

		– të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e objekteve ose prodhime gjysmë të gatshme prej druri. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.
e në makina të avancuara të ë kopjuese cnc.(makinë kontroll normave; nc. sipas procesit të punës; ër të kontrolluar programimin; alet në makinën cnc: sipas kuadruese sipas përmasave në ruese për të kontrolluar detalet, sipas modelit, në makinë. në makinën borduese sipas orduese sipas procesit të punës; ese për të kontrolluar rat apo detalet sipas modelit; lloit të aksesorit metalik që do ontrolluar programimin; aksesorin metalik; bëra me makinat e avancuara të avancuara të përpunimit të drurit, s; urimit teknik dhe ruajtjes së proceseve të punës me makinat e të drurit.	RN 2	Nxënësi ndjek kryerjen e proceseve të punes në makineri për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme, në mobileri, ndërtim etj. Kriteret e realizimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë : – të ndjekë matjen dhe shënimin mbi material; – të gradojë makinën sipas procesit të punës; – të ndjekë sharrimin e trupave në gatër, sharrë shirit sipas modelit të prerjes; – të ndjekë drejtimin e materialit në brinjë sipas trashësisë në skicë; – të ndjekë sharrimin e materialit në gjatësi sipas skicës; – të ndjekë drejtimin e elementeve të objektit; – të ndjekë punimet në makinën grosecë; – të ndjekë shkurtimin e elementeve,sipas skicës, në përmasa fikse; – të ndajë dhe shënojë elementet sipas vendit në objekt; – të ndjekë shpimin e elementeve sipas përmasës në skicë; – të ndjekë thithëzimn e elementëve sipas përmasës në skicë; – të ndjekë profilimin sipas modelit të elementeve; – të ndjekë tornimin apo prerjen plane të trupave për prodhimin e rimesos teknike apo dekorative; – të ndjekë copëtimin e drurit në ashkla për pllakë zdrukthi; – të ndjekë defibrimin e ashklave të drurit dhe rafinimin e fibrave; – të ndjekë kontrollin e punimeve të kryera në makina; – të ndjekë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punes në makineri për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.

lli.

RN 4	Nxënësi ndjek proçese pune të ngjitjes dhe presimit për realizimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të ndjekë përgatitjen e lëndës ngjitëse sipas recetave; – të përgatitë makinën e lyerjes me lëndë ngjitëse për punë; – të ndjekë lyerjen me lëndë ngjitëse të detaleve, ashklave,
-------------	--

- fibrave, etj. sipas normativës;
- të kontrollojë materialin e lyer sipas cilësisë;
- të përgatitë presën për punë sipas normave;
- të ndjekë procesin e presimit sipas rregjimit të telajove, pllakave të zdrukthit, fibrës, rimesos, etj.;
- të kontrollojë cilësinë, sipas standartit, mbas presimit;
- të ndjekë trajtimin mbas presimit si aklimatizimin për kompensatën, pllakën e zdrukthit, fibrës, panelit etj.;
- të ndjekë trajtimin termik të pllakës së fibrës sipas parametrave;
- të ndjekë kujdesin për pajisjet dhe instrumentet gjatë kryerjes së proceseve të punës së tharjes, ngjitjes, presimit, aklimatizimit dhe trajtimit termik në prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme;
- të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës së ngjitjes, presimit dhe trajtimit për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi ndjek dhe kryen procese pune te pllakat me bazë druri .

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndjekë skuadrimin e pllakave të ndryshme, me bazë druri si pllakë zdrukthi, fibre, dru i shtresuar, kompensatë etj., me makina të thjeshta;
- të programojë makinën skuadruese cnc. sipas përmasave në skicë;
- të skuadrojë pllaka të ndryshme, me bazë druri si pllakë zdrukthi, fibre, dru i shtresuar, kompensatë etj., në makinën cnc: sipas modelit;
- të ndjekë kalibrimin e pllakave të ndryshme me bazë druri me makina kalibruese, në trashësinë e kërkuar;
- të ndjekë hapjen e vrimave e foleve në pllaka, sipas skicës;
- të ndjekë përgatitjen sipas skicës së kunjave bashkuese për pllakat me bazë druri;
- të ndjekë përgatitjen e sipërfaqes së pllakave me bazë druri, sipas standartit, për lustrim;
- të ndjekë zumparimin sipas kërkesës së pllakave me bazë druri si zdrukthi, fibre, panel etj.;
- të ndjekë ngjyrosjen e pllakave me bazë druri sipas modelit;
- të ndjekë lyerjen me pastë poliuretan, për mbushjen e poreve në sipërfaqen e pllakave me bazë druri si panel, qelizore, zdrukthi, fibre etj.;
- të ndjekë realizimin e tharjes së shtresës së pastës me poliuretan, në pllakën me bazë druri, në paisjet përkatëse

- sipas rregjimit;
- të ndjekë zumparimin e sipërfaqes së materialit drunor sipas shkallës së pastërtisë;
- të ndjekë pastrimin e sipërfaqes së pllakës me bazë druri mbas zumparimit;
- të kontrollojë dhe eliminojë me kujdes defektet në sipërfaqen e pllakës me bazë druri;
- të ndjekë përgatitjen e materialit për lustrim sipas recetës përkatëse;
- të ndjekë lyerjen me poliuretan të pllakave të zdrukthit, fibrës etj. sipas normativës;
- të realizojë tharjen e llustrës duke ndjekur rregjimin në paisjet përkatëse;
- të përcaktojë cilësinë e pllakave sipas standardeve.
- të ndjekë amballazhimin e pllakave me bazë druri si rimeso, kompensatë, pllakë zdrukthi, panel etj., sipas kërkesës ;
- të ndjekë magazinimin e pllakave me bazë druri sipas kërkesave ;
- të kujdeset për pajisjet dhe instrumentet gjatë ndjekjes dhe kryerjes së proceseve të punës me pllakat me bazë druri (panele) ;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë ndjekjes dhe kryerjes së proceseve të punës me pllakat me bazë druri (panele).

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi ndjekë procese të montimit dhe përfundimit për objekte prej druri ose gjysmë të gatshme në mobileri, ndërtim etj.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndjekë, sipas rradhës, montimin paraprak të mobljes ;
- të ndjekë montimin paraprak të nyjes së kapriatës; kallëpeve, trarëve të rumbullakët për ndërtim etj.;
- të ndjekë korigjimin e defekteve gjatë montimit paraprak;
- të ndjekë ngritjen e skeletit të objektit prej druri;
- të ndjekë montimet plotësuese ;
- të ndjekë përgatitjen e sirtareve sipas skicës;
- të ndjekë vendosjen e aksesorëve plotësues;
- të eliminojë defektet e krijuara;
- të ndjekë montimin përfundimtar të objektit ;
- të ndjekë amballazhimin dhe magazinimin e objektit sipas kërkesës ;
- të ndjekë kujdesin për pajisjet dhe instrumentet gjatë kryerjes të proceseve të montimit dhe përfundimit të objekteve prej druri ;
- të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe

ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të montimit, dhe përfundimit të objekteve prej druri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 7 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë llogaritjet ekonomike për prodhimin objektit prej druri si mobilje, objekte speciale prej druri, prodhime gjysmë të gatshme, objekte druri për fushën e ndërtimit etj.;
- të përcaktojë koston në punimin e objektit prej druri ose gjysmë të gatshme;
- të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materiale;
- të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.);
- të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh etj.);
- të llogaritë detyrimet fiskale në bizneset e vogla të profilit “përpunim druri”;
- të llogaritë të ardhurat, fitimin në një biznes të vogël perpunim druri gjatë prodhimit të objekteve prej druri si mobilje, objekte speciale prej druri, prodhime gjysmë të gatshme, objekte druri për fushën e ndërtimit etj.;
- të përgatitë faturën për koston e objektit prej druri ose gjysmë të gatshme;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të prodhimit të objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e proceseve të punës për prodhimin objektit prej druri si mobilje, objekte speciale prej druri, prodhime gjysmë të gatshme, objekte druri për fushën e ndërtimit etj.
- Të organizojë edhe vizita në punishte apo fabrika ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës të prodhimit të objekteve prej druri si mobilje, objekte speciale prej druri, prodhime gjysmë të gatshme, objekte druri për fushën e ndërtimit etj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve për prodhimin objekteve prej druri si

	mobilje, objekte speciale prej druri, prodhime gjysmë të gatshme, objekte druri për fushën e ndërtimit etj. – fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin objekteve prej druri si mobilje, objekte speciale prej druri, prodhime gjysmë të gatshme, objekte druri për fushën e ndërtimit etj. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të prodhimit të objekteve prej druri si mobilje, objekte speciale prej druri, prodhime gjysmë të gatshme, objekte druri për fushën e ndërtimit etj. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënësve.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	– Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e mëposhtme: – Repart, fabrikë të prodhimit të objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme. – Makina, mjete të nevojshme për prodhimin për prodhimin objektit prej druri si mobilje, objekte speciale prej druri, prodhime gjysmë të gatshme, objekte druri për fushën e ndërtimit etj. – Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese. – Material drunor, dërrasë, detale druri, rimeso, ashkla druri, fibra druri, etj., – Skica e skema të objekteve prej druri. – Skema të linjave teknologjike të prodhimit të objektit prej druri ose gjysmë të gatshme prej druri. – Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesat, – Kompletet e veshjeve të punës.

3. Moduli “Ndjekja e procesit të tharjes së lëndës drunore ”

Drejtimi: Përpunim druri
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PERSHKUESII I MODULIT		
Titulli dhe kodi	NDJEKJA E PROCESIT TE THARJES SË LËNDËS DRUNORE	M-09-1544-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të ndjekur procesin e tharjes natyrore dhe artificiale të lëndës së parë me bazë druri si lëndë e sharruar, rimeso teknike, dekorative, ashkla, apo fibra druri.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, të kualifikimit në drejtimin mësimor “Përpunim druri”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi ndjek dhe kryen procese për përgatitjen e vendit të punës për tharjen e materialit drunor, në natyrë, dhoma, tunele, pajisje dhe makina. Kriteret e realizimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të zgjedhë metodën e tharjes në lidhje me mjedisin; – të zbatojë kriteret e caktuara për zgjedhjen e tipit të tharëses sipas materialit apo kushteve që ka, për lëndën e sharruar apo rimeson teknike, ashklat, fibrat e drurit etj.; – të ndjekë impiantet e tharjes, funksionimin dhe përdorimin e tyre; – të analizojë skicat e dhomës, pajisjes dhe makinës për të parë kapacitetin dhe kompletimin e tyre; – të ndjekë përcaktimin e radhës së punës për tharjen natyrore të lëndës së sharruar, detaleve të ndryshme prej druri apo rimesos dekorative; – të zgjedhë materialet sipas llojit të përmasave, lagështisë fillestare etj.; – të ndjekë zgjedhjen e pajisjeve të transportit të materialit drunor në tharëset përkatëse si transportierë, vagoneta, ura tërthore etj.; – të përcaktojë instrumentet dhe pajisjet e kontrollit të regjimit të tharjes, funksionimin dhe përdorimin e tyre; – të zgjedhë regjimin e tharjes sipas kriterëve të caktuar; – të llogaritë prodhimtarinë vjetore të pajisjes tharëse; – të përcaktojë numrin e tharëseve në funksion të prodhimtarisë vjetore; – të ndjekë organizimin e vendit të punës sipas rradhës;	

-
- të kontrollojë terrenin e stivimit të materialit drunor sipas kushteve të caktuara;
 - të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes të vëndit të punës për realizimin e proceseve të punës në tharjen natyrore, në dhoma, tunele, pajisje dhe makina të materialit drunor si lëndë e sharruar, rimeso teknike, dekorative, ashkla, apo fibra druri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi ndjek dhe kryen proçese të punës për përgatitjen e materialit drunor për tharje.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përgatitë materialin drunor që mund të jetë dërrasë, rimeso, ashkla, fibra etj, për tharje;
- të përcaktojë llojin e materialit drunor që do të thahet (ah,plep,meshteknë etj.);
- të kontrollojë përmasat e materialit drunor në trashësi, gjerësi etj;
- të kontrollojë lagështirën fillestare të materialit drunor me aparat matës të lagështirë;
- të përcaktojë specifikat e organizimit të tharjes natyrale në bashkëpunim me eprorët;
- të kryejë llogaritjet e sasisë të avullit të nevojshëm për tharje;
- të ndjekë stivimin e materialit sipas normave të caktuara.
- të përgatitë provat treguese sipas kërkesave;
- të vendosë provat në stivë sipas normave;
- të ndjekë furnizimin e makinave tharëse të rimesos teknike, ashklave, fibrave të drurit sipas rregullave të caktuara;
- të përcaktojë kriteret e përzgjedhjes së regjimit të tharjes së lëndës drunore, duke analizuar parametrat përkatës në bashkëpunim me eprorët;
- të zbatojë mënyrën e llogaritjes së prodhimtarisë në tharëse;
- të përcaktojë mënyrat e identifikimit të defekteve të tharjes dhe shkaqet e tyre;
- të ndjekë funksionimin dhe përdorimin e kaldajave, sipas llojeve;
- të ndjekë kujdesin për veglat, pajisjet dhe makinat gjatë përgatitjes të materialit drunor për tharje;
- të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune gjatë përgatitjes të materialit drunor për tharje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi përgatit tharësen për punë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të lejojë kalimin e avullit në kaloriferët që ndodhen në dhomën, pajisjen, makinën etj. në momentin e duhur;
- të hapë tubat e njomjes për ngrohjen paraprake të dhomës, paisjeve të saj dhe materialit drunor;
- të vendosë në punë kondensatorët për largimin e ujit;
- të vendosë në punë ventilatorët për të rregulluar shpejtësinë e lëvizjes së ajrit në tharëse;
- të vendosë në pozicion 0 aparatet matës të parametrave të mjetit tharës si termometra, anemometra, aparate të lagështirës etj;
- të vendosë materialin në tharëse sipas normave. të mbyllë në mënyrë hermetike tharësen;
- të ndjekë kujdesin për pajisjet dhe instrumentet gjatë përgatitjes së tharëses për punë;
- të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tharëses për punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi ndjek procesin e tharjes natyrore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontrollojë temperaturën e ajrit të atmosferës me termometër;
- të kontrollojë presionin e ajrit të atmosferës me aparatën përkatës;
- të kontrollojë shpejtësinë e lëvizjes të ajrit të atmosferës me anemometër;
- të kontrollojë lagështirën relative të ajrit;
- të kontrollojë defektet që mund të shkaktohen gjatë tharjes natyrore;
- të kontrollojë mbulesat e stivave sipas normave të caktuara;
- të mbajë shënime për cdo matje dhe kontroll të bërë.
- të kontrollojë lagështirën përfundimtare të materialit drunor;
- të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë ndjekjes së procesit të tharjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi ndjek dhe kryen procese gjatë tharjes artificiale të materialit drunor në dhoma, pajisje, makina.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontrollojë temperaturën e mjetit tharës me termometrin teknik;
- të kontrollojë presionin e mjetit tharës me manometër.
- të kontrollojë shpejtësinë e lëvizjes të mjetit tharës me anemometër;
- të kontrollojë kohën e tharjes;
- të krahasojë matjet e aparateve matës me të dhënat në tabelat e rregjimit të tharjes;
- të mbajë shënime për cdo matje të bërë gjatë rregjimit për ta transmetuar te turni tjetër;
- të ndjekë marrëdhëniet e përmbajtjes së lagështisë në dru me vetitë dhe performancën;
- të kontrollojë shformimet që mund të krijohen gjatë tharjes me ndihmën e provëzave të kontrollit;
- të marri masat për evitimin e shformimeve në kohën e duhur;
- të kontrollojë lagështirën përfundimtare të materialit drunor sipas kërkesës;
- të kontrollojë shpërndarjen e lagështirës përfundimtare në seksion të lëndës drunore;
- të realizojë periudhën e ekuilibrit po të jetë e nevojshme, sipas një rregjimi të caktuar;
- të ndjekë mirëmbajtjen e pajisjeve dhe instrumentave matës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë ndjekjes të procesit të tharjes artificiale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimit të nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të përunimit të drurit me depozita të tharjes natyrore, dhoma, paisje, makina tharëse.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e proceseve të punës për tharjen e lëndës së parë, të organizojë edhe vizita në punishte apo fabrika ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës për tharjen e materialit drunor, si dërrasë, rimeso, zdrukthe, fibra etj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve për tharjen e lëndës të drurit. fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për tharjen e materialit drunor, si dërrasë, rimeso, zdrukthe, fibra etj.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve për tharjen e materialit drunor, si dërrasë, rimeso, zdrukthe, fibra etj.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e

kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e mëposhtme:

- Repart, fabrikë me dhoma, pajisje, makina për tharjen e lëndës së drurit.
 - Komplet i pajisjeve për rregullimin e parametrave të mjetit tharës.
 - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
 - Materiali drunor, dërrasë, detale druri, rimeso, ashkla druri, fibra druri etj.
 - Skica e skemës të dhomave, paisjeve, makinave tharëse, mënyrës të stivimit, provëzave tërëguese etj.
 - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesat,
 - Komplet i veshjeve të punës.
-

4. Moduli “Punime me programe kompjuterike AutoCAD dhe EXCEL”

Drejtimi: Përpunim druri
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME ME PROGRAME KOMPJUTERIKE AUTOCAD DHE EXCEL	M-26-2043-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të realizuar vizatime teknike të përpunimit të drurit me anë të programit <i>AutoCAD</i> dhe për të përdorur programin <i>EXCEL</i> .	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, të kualifikimit në drejtimin mësimor “Përpunim druri”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi parapërgatit realizimin e vizatimit teknik të përpunim drurit me <i>AutoCAD</i>. Kriteret e vlerësimit: Nxënësit duhet të jenë të aftë: – të përzgjedhin një objekt kompleks ose të konceptojë një ide të përshtatshme për një vizatim teknik kompleks; – të analizojnë drejt objektin/idenë që do të paraqitet me anë të vizatimit teknik në <i>autocad</i> duke përcaktuar hapat e duhur; – të përcaktojnë parametrat e duhur të vizatimit teknik që do të përgatitet; – të skicojnë sipas rregullave në letër (me dorë) draftin e vizatimit teknik që do të realizohet me <i>autocad</i>; – të vënë në punë kompjuterin duke respektuar radhën e veprimeve; – të hapin programin <i>autocad</i> specifik për vizatimin teknik që do të realizohet duke respektuar radhën e veprimeve. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi realizon vizatimin teknik me <i>AutoCAD</i>. Kriteret e vlerësimit: Nxënësit duhet të jenë të aftë: – të përgatitin një faqe të re për vizatimin teknik që do të realizohet duke respektuar radhën e veprimeve; – të aplikojnë sipas rregullave parametrat e kërkuar (formatin, shkallën, etj.); – të vendosin sipas rregullave koordinatat;	

- të realizojnë vizatimin e objekteve të kërkuara (vija, rrathë, harqe, elipse, drejtkëndësja, shumëkëndësja, figura komplekse etj.) duke respektuar radhën e veprimeve;
- të realizojnë vizatimin e shtresave, llojeve dhe trashësive të ndryshme të vijave duke respektuar radhën e veprimeve;
- të aplikojnë sipas rregullave efektet e ndryshme në vizatim;
- të realizojnë ngjyrosjet dhe hijet e kërkuara sipas shenjave dalluese përkatëse;
- të realizojnë seksionimet e kërkuara sipas shenjave dalluese përkatëse;
- të vendosin përmasat dhe tolerancat e sakta në vizatim.
- të shkruajnë tekstet dhe simbolet e kërkuara;
- të bëjnë sipas rregullave editimin e vizatimit teknik (selektime, prerje, zhvendosje, kopjime, ndryshim madhësie etj.);
- të aplikojnë sipas rregullave filtrat;
- të përgatitin sipas rregullave dokumentin për printim;
- të printojnë sipas rregullave dokumentin;
- të ruajnë sipas rregullave dokumentin.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi ndërton tabela punimesh/lista materialesh me programin EXCEL.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të interpretojnë projektin dhe librat e masave;
- të hyjnë në programin EXCEL me menunë përkatëse;
- të përdorin dritaren e faqes së punës në EXCEL (rrjetën me kolona dhe rrjeshta) dhe qelizën me adresën përkatëse;
- të selektojnë dhe aktivizojnë qelizën;
- të përdorin metodat e editimit (kopjimin, zhvendosjen, fshirjen);
- të shkruajnë në qelizë dhe ruajnë të dhënat (nr; rendor, nr; i analizës, emërtimi i punimeve, njësia matëse, sasia dhe çmimi) sipas manualeve;
- të përdorin formulat për llogaritjen e vlerave (për çdo zë punimi/materiali dhe emërtim punimesh/materialesh) deri në vlerën totale të projektit;
- të ruajnë materialin me ndryshimet e bëra, kontrollojnë faqen e punës (në zoom) dhe ta printojnë atë;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet në klasën ose laboratorin e praktikës së kompjuterave. – Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të veprimeve në kompjuter për realizimin e vizatimeve teknike të përpunim drurit me programin <i>AutoCAD</i>.si dhe ndërtimin e tabelave punimesh/lista materialesh me programin EXCEL. – Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për përgatitjen, realizimin dhe printimin e vizatimeve teknike të përpunimit të drurit me programin <i>AutoCAD</i> si dhe ndërtimin e tabelave punimesh/lista materialesh me programin EXCEL, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. – Mësuesi/instruktori duhet të nxisë nxënësit të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të tyre.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë ose laborator kompjuterash. - Kompjutera personale me programin <i>AutoCAD</i> dhe EXCEL. - Objekte të ndryshme që do të vizatohen. - Printer. - Fomate letrash për vizatime teknike. - Manual i përdorimit të programit <i>AutoCAD</i>. - Manual i përdorimit të programit EXCEL.

X. Programi orientues i Praktikës Profesionale të Integruar, të nivelit

Në përfundim të nivelit të III-të në drejtimin mësimor **”Përpunim druri”**, **Niveli III AP (Niveli IV i KSHK)**, nxënësit i nënshtrohen Provimit Përfundimtar të praktikës profesionale të integruar, në zbatim të udhëzimit nr. 15, datë 26.04.2020 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në Arsimin dhe Formimin Profesional”.

Programi orientues për provimet përfundimtare të drejtimit mësimor **”Përpunim druri”**, përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë drejtim mësimor, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 13-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu edhe mësuesit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në shkollat e larta apo në arsimin pas të mesëm.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësuesit/instruktorët të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në drejtimin mësimor **”Përpunim druri”**, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës dhe pikët** për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Posti i punës	Pikët
1	Të kryejë planifikimin dhe organizimin e punës për zbatimin e projekteve në përpunimin e drurit .	Detyra 1: “Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve për planifikimin dhe organizimin e punës për zbatimin e një projekti në përpunimin e drurit”	20
2	Të prodhojë objekte prej druri, ose gjysmë të	Detyra 2: “Vlerësimi i një	35

	gatshme.	ose më shumë prej proceseve për prodhimin e një objekti prej druri, ose gjysmë të gatshme	
3	Të ndjekë procesin e tharjes së lëndës drunore.	Detyra 3: “Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve për ndjekjen e tharjes së lëndës drunore”	20
4.	Të kryejë vizatime teknike të përpunimit të drurit me <i>AutoCAD</i> dhe EXCEL	Detyra 5: “Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve për kryerjen e vizatimeve teknike të përpunimit të drurit me <i>AutoCAD</i> dhe EXCEL ”	25
	Shuma		100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “poste pune”, grupe pune ose në mënyrë individuale, në bazën prodhuese të shkollës.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Udhëzimin nr. 15. Datë 26.04.2019 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në arsimin dhe formimin profesional” në fuqi.
- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë domosdoshmërisht të përfshira në vlerësim.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësim dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë paraprakisht pyetjet për bashkëbisedimin profesional.
- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit duke u testuar/vlerësuar në një nga proceset e punës për çdo detyrë, kjo edhe për shkak të kohës së kufizuar 3 orë të provimit praktik.

- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme. Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për produktin përfundimtar.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.

Realizimi i Detyrës 1: “Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve për planifikimin dhe organizimin e punës për zbatimin e një projekti në përpunimin e drurit .

Nxënësi duhet të testohet për një ose më shumë procese pune si:

Ndjekja e kryerjes së proceseve të punës për ngritjen e një reparti të përpunimit të drurit

Ndjekja kryerjes së proceseve të punës për planifikimin e punimeve për ngritjen e një reparti,

Ndjekja kryerjes së proceseve të punës për organizimin e punimeve për ngritjen e një reparti të përpunimit të drurit

Ndjekja kryerjes së proceseve të punës të sigurimit dhe ruajtjes së lëndës së parë

Nxënësi i vihet në dispozicion pajisjet dhe materialet e nevojshme për realizimin e detyrës.

Detyra përcaktohet dhe jepet me short, e me pas nxënësi realizon preceset e përcaktuara në këtë detyrë.

Nxënësi testohet për përzgjedhjen e materialeve dhe veglave të domosdoshme si dhe për një ose më shumë prej proceseve të ndjekjes së punimeve për planifikimin dhe organizimin e punës për zbatimin e një projekti në përpunimin e drurit. Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në procesin/proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Realizimi i Detyrës 2: “Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve për prodhimin e një objekti prej druri, ose gjysmë të gatshme”

Nxënësi duhet të testohet për një ose më shumë procese pune si: Përgatitja e vendit të punës për ndjekjen dhe kryerjen e punimeve përgatitore për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme; Kryerja e proceseve të punës në makineri për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme; Kryerja e proceseve të punës në makina të avancuara të përpunimit të drurit; Ndjekja e proceseve të punës të ngjitjes dhe presimit për realizimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme; Ndjekja e proceseve të punës për veshjen me tapiceri të objekteve prej druri; Kryerja e proceseve të punës me pllakat me bazë druri (pane); Ndjekja e proceseve të montimit dhe përfundimit për objekte prej druri; Kryerja e proceseve të restaurimit të objekteve prej druri; Ndjekja dhe kryerja e proceseve për realizimin e objekteve prej druri për ndërtim si, kapriatë, kallëpe, trarë të rumbullakët; Kryerja e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të

gatshme.

Të gjitha hapat e provimit ndiqen si detyrat më sipër.

Realizimi i Detyrës 3: “Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve për ndjekjen e tharjes së lëndës drunore”

Nxënësi realizon një ose disa prej proceseve të mëposhtme:

Ndjekja dhe kryerja e proceseve për përgatitjen e vendit të punës për tharjen e materialit drunor, në natyrë, dhoma, tunele, pajisje dhe makina; Ndjekja dhe kryerja e proceseve të punës për përgatitjen e materialit drunor për tharje; Ndjekja e procesit të tharjes natyrore e artificial dhe kryerja e proceseve gjatë tharjes artificiale të materialit drunor në dhoma, pajisje, makina.

Të gjitha hapat e provimit ndiqen si detyrat më sipër.

Realizimi i Detyrës 4: “Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve për kryerjen e vizatimeve teknike të përpunimit të drurit më AutoCAD dhe EXCEL ”

Nxënësi kryen njërin ose disa nga proceset e mëposhtme:

Parapërgatitja, realizimi i vizatimit teknik për përpunimin e drurit me *AutoCAD*; Përdorimi i komandave të duhura për realizimin e një vizatimi të ri; Përdorimi i disa prej mënyrave të vizatimit të drejtëzës në *AutoCAD*; Vizatimin e një prej figurave gjeometrike si trekëndësh, drejtkëndësh, shumkëndësh në *AutoCAD*. Përdorimi i komandave të menusë së modifikimit; Pjesëmarrje në realizimin e vizatimit teknik me *AutoCAD*, ndërtimin e tabelave të punimeve /listave të materialeve me programin *EXCEL*, Përdorimi i dritares së faqes së punës në *EXCEL*,Selektimi dhe aktivizimi i qelizës ,Përdorimi i metodave të editimit,Përdorimi i formulave për llogaritjen e vlerave deri në vlerën totale të projektit;

Të gjitha hapat e provimit ndiqen si detyrat më sipër.